

L I G J
Nr .7505, datë 31.7.1991

PËR BANKËN E KURSIMEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Banka e Kursimeve është institucion shtetëror i pavarur, bën pjesë në sistemin bankar të Republikës së Shqipërisë dhe ka këto detyra:

- a) kryen veprimtari për depozitat e kursimit të mjeteve monetare të shtetasve.
- b) kryen veprimtari për depozitat e kursimit në valutë të huaj për shtetasit shqiptarë të huaj;
- c) jep kredi afatshkurtër e afatgjatë
- ç) kryen shërbime të ndryshme.

Neni 2

Çdo shtetas ka të drejtë të depozitojë mjetet e tij monetare në Bankën e Kursimeve. Depozituesi ka të drejtë ta disponojë lirisht e në çdo kohë depozitën e tij. Depozitimi në Bankën e Kursimeve mund të bëhet edhe në emrin e një personi të tretë. Rregullat, kushtet dhe afatet për depozitat e kursimit caktohen nga Banka e Kursimeve.

Neni 3

Depozituesi ka të drejtë të autorizojë me prokurë persona të tjerë për të bërë tërheqje nga depozita e tij.

Prokura për depozituesin me banim në Republikën e Shqipërisë lëshohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Prokura, për depozituesit që ndodhen jashtë shtetit, duhet të jetë lëshuar e vërtetuar nga organet e autorizuar dhe në mënyrë që përcaktohen në ligjin e vendit ku ndodhet depozituesi.

Neni 4

Depozita e kursimit u jepet trashëgimtarëve sipas dispozitave të Kodit Civil.

Banka e Kursimeve, nga depozita e kursimit e trashëgimtarëve, i paguhen njërës prej trashëgimtarëve shpenzimet e varrimit pas paraqitjes së një deklarate të vërtetuar nga organet lokale të pushtetit.

Kur shpenzimet e varrimit përballohen nga një person tjetër që nuk është trashëgimtar, Banka e Kursimeve i paguan atij shpenzimet e vërtetuara.

Neni 5

Banka e Kursimeve ruan fshehtësinë e depozitave.

Informata për depozitat e kursimit u jepet :

- a) Depozituesve ose personave të autorizuar prej tyre.
- b) Organeve të hetuesisë për çështje penale, me autorizim të prokurorit.
- c) Organeve gjyqësore për çështje penale, për pjestimin e pasurisë bashkëshortore dhe për detyrimin ushqimor.

Neni 6

Gjykata ose hetuesia, në rastet e parashikuara nga neni 5, kanë të drejtë të vendosin bllokimin e depozitës së depozituesit deri në përfundimin e çështjes dhe për këtë njoftojnë degët e Bankës së Kursimeve.

Ekzekutimi i detyrueshëm mbi depozitat e bllokuara mund të bëhet vetëm në bazë të një vendim penal ose civil, të dhënë nga gjykata e që ka marrë formë të prerë.

Neni 7

Banka e Kursimeve cakton objektet e kredive afatshkurtëra dhe afatgjata, rregullat, kushtet dhe afatet e dhënies e të kthimit të tyre.

Neni 8

Banka e Kursimeve cakton interesat bankare për depozitat e kursimit dhe për kreditë afatshkurtëra e afatgjata.

Për shërbimet që u kryhen personave juridikë a fizikë. Banka e kursimeve mban komisione e shpenzime, sipas tarifave që caktohen prej saj.

Neni 9

Banka e Kursimeve ka këto fonde :

a) Fondin e themelimit prej 50 milion lekësh.

b) Fondin rezervë.

c) Fondin e mjeteve kryesore

Fondi rezervë krijohet nga fitimi i Bankës së Kursimeve dhe përdoret prej saj.

Neni 10

Banka e kursimeve ka këto organe:

a) Këshilli Administrativ

b) Drejtori e zëvendësit e tij.

Këshilli Administrativ miraton statutin e Bankës.

Drejtori i Bankës së Kursimeve emërohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11

Banka e Kursimeve ushtron veprimtarinë e saj ekonomike e financiare në mënyrë të pavarur dhe i paguan shtetit tatimet e taksat e përcaktuara me ligj. Për pjesën tjetër të fitimit vendos Këshilli Administrativ i Bankës.

Banka e Kursimeve i nënshtrohet kontrollit të shtetit dhe bilanci i saj, pasi të jetë miratuar nga Këshilli administrativ i paraqitet Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Shteti garanton depozitat e kursimit të popullsisë të depozituara në Bankën e Kursimeve.

Neni 13

Banka e Kursimevë është person juridik me qendër në Tiranë dhe ka rrjetin e saj në rrethe (degë e arka kursimi).

Degët e Bankës së Kursimeve varen nga drejtori i Bankës së Kursimeve dhe për kryerjen e funksioneve e detyrave të tyre ato kontrollohen e japin llogari para tij.

Drejtori i Bankës së Kursimeve drejton Bankën dhe përgjigjet për gjithë veprimtarinë e saj, e përfaqëson atë ose autorizon persona të tjerë që ta përfaqësojnë. Ai vepron në përputhje dhe brenda kompetencave që i jepen nga Këshilli Administrativ ose që përcaktohen në Statutin e Bankës .

Neni 14

Ligji nr.6600, datë 30.6.1982 "Për Institutin e Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve", shfuqizohet.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
RAMIZ ALIA